

Prishtinë: 27 maj 2009
Kodi i ZRRE-së: V_193_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Dispozitat e Nenit 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 2 të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
3. Kërkesën për aprovim të formës së kontratës për konsumatorët shtëpiak dhe konsumatorët jo-shtëpak, të bërë nga Korporata Elektroenergjetike e Kosovës (KEK SH.A),

në seancën e mbajtur më 27 maj 2009 nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** forma e këtyre kontratave të KEK Sh.A-së:
 1. Kontratë për furnizim me energji elektrike për konsumatorët shtëpiak dhe
 2. Kontratë për furnizim me energji elektrike për konsumatorët jo-shtëpiak

Arsyetim

1. KEK Sh.A - Divizioni i Furnizimit Publik, bazuar në Nenet 2, 4.2 dhe 16 të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, dhe sipas Nenit 6.6 të "Licencës për Furnizim Publik me Energji Elektrike-KEK Sh.A", ka përgatitur dhe dorëzuar për aprovim në ZRRE formën e Kontratës për furnizim me energji elektrike për konsumatorët shtëpiak dhe formën e Kontratës për furnizim me energji elektrike për konsumatorët jo-shtëpiak.
2. ZRRE ka vlerësuar kërkesën e KEK SH.A-së dhe pas vlerësimit të formës së këtyre kontratave, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
3. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
4. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda katërbëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

*Bashkëngjitur në këtë vendim janë:

1. Forma e Kontratës për furnizim me energji elektrike për konsumatorët shtëpiak dhe
2. Forma e Kontratës për furnizim me energji elektrike për konsumatorët jo-shtëpiak

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar